



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Raport për tremujorin e dytë 2020

Oda e Mjekëve të Kosovës



Korrik 2020

Prishtinë

Përmbajtja:

Raport për tremujorin e dytë 2020	1
1. Këshilli Drejtues.....	3
2. Anëtarësimi	3
3. Mbikëqyrja etiko-profesionale	4
4. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional	6
5. Licencimet.....	6
6. Edukimi specialistik-zbërthimi i kompetencës bazuar në Ligjin për Shëndetësi dhe Ligjin për OPSH-të	6
7. Këshilli Mbikëqyrës	6
8. Komisioni për Çështje Etike i OMK-së	7
9. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke	7
10. Raporti financiar.....	7
10.1 Gjendja financiare – 30 qershor 2020	7
10.2 Përkrahje për Edukim të Vazhdueshëm Profesional	8
10.3 Prokurimi	8
11. Aktivitete të tjera	8
11.1 Shërbimi profesional.....	8
11.2 Tryeza e rumbullakët 'Ligji i pagave dhe Mjekët e papunë'	8
11.3 Kongresi vjetor	9
11.4 Revista mjekësore e Odës së Mjekëve të Kosovës	9
11.5 Marrëdhënie ndërkombëtare.....	9
11.6 Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike	10
11.7 Shpallja e Emergjencës së shëndetit publik	10
12. Plani i veprimit për 2020.....	11

1. Këshilli Drejtues

Në periudhën kohore prill–qershor 2020, Këshilli Drejtues i OMK-së ka mbajtur dy (2) takime, ku janë shqyrtuar lëndët si më poshtë:

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën TM2	Vendimet sipas kërkesave/a nkesave së pranuar për periudhën TM2	Vendimet në procedurë	Vendimet e Këshillit Drejtues për periudhën TM2	Vendime për lëndët e bartura nga periudhat paraprake
Këshilli Drejtues i Odës	7	0	6	<p>1-Vendim për formimin e komisioneve të zgjedhjes dhe ankesave për IT;</p> <p>2- Vendim i fillimit të procedurave të prokurimit për përkthim dhe lektorim të dokumenteve të OMK-së;</p>	4

2. Anëtarësimi

Gjatë periudhës prill-qershor 2020, në Odën e Mjekëve të Kosovës u anëtarësuan 61 mjekë, ku 3 mjekë janë të huaj dhe 58 mjekë vendas (përfshirë 2 mjekë të punësuar në sektorin publik, 8 mjekë të punësuar në sektorin privat, 48 mjekë të pa punë).




Tabela 1.1: Anëtarësime për periudhën prill-qershor 2020




Tabela 1.2: Totali i përgjithshëm i anëtarëve deri me datën 30 qershor 2020

Gjatë periudhës prill-qershor 2020 ka ndodhur 1 ndërprerje në anëtarësi si dhe janë ç'anëtarësuar në mënyrë vullnetare 3 mjekë, numri total i anëtarëve deri me datën 30 qershor është 4440.

3. Mbikëqyrja etiko-profesionale

Për ta pasqyruar ecurinë e mbikëqyrjes etike dhe profesionale pranë organeve të Odës, në mënyrë tabelare do të paraqesim ushtrimin e funksionit të tillë nga ana e organeve të odës.


Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën TM2	Vendimet sipas procedurës së zhvilluar për periudhën TM2	Sanksionet e shqiptuara për periudhën TM2	Sanksionet e ekzekutuara për periudhën TM2	Lëndët e bartura nga periudhat paraprake	Lëndët në shqyrtim
Prokurori i Odës	12	30	///	///	8	4
Këshilli Etik	8	17 (12 vendime dalin nga 1 lëndë)	Rekomandime kolegjale 2 Qortim Publik 0 Gjoba 4: Gjithsej : 0 00.00€ Paushalli i procedurës:50x2 100€	Qortim publik 0 (00.00€) Gjoba 0 (0.00€) Gjithsej: 00.00€ Shpenzime te paushallit : 1 50€	1	3
Gjyqi i Nderit	2	2	Sipas ankesës është vërtetuar vendimi i Këshillit Etik nr. KE 02-5/2020	///	0	0
Certifikatat e të kaluarës etike	21	///	///	///	///	///

Në shqyrtim të drejtpërdrejtë, është mbajtur 1 seancë e shqyrtimit kryesor, në të cilin është mundësuar përfaqësimi i drejtpërdrejt i palëve në procedurë, përfshirë të drejtën në përfaqësues me autorizim (prokurë). Ndërkaq në procedurën e mjetit juridik, pranë Gjyqit të Nderit, është ndryshuar një lëndë si rrjedhojë e paraqitjes së fakteve të reja të cilat nuk janë parashtruar pranë Këshillit Etik.

Vërejtje: Lëndët e pasqyruara në tabelë përfshijnë lëndë që aktualisht ndonjëra prej tyre janë në procedim nga një organ në tjetrin. Për shkak të natyrës së procedurave është e pamundur që të nxirret në total bilanci i lëndëve, për shkak të qarkullueshmërisë së lëndës, varësisht nga faza procedurale në të cilën gjendet lënda e tillë.


4. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional

Komisioni për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional gjatë periudhës prill-qershor 2020, ka akredituar 8 aktivitete.



5. Licencimet

Komisioni për Licencim dhe Ri-licencim profesional gjatë periudhës prill-qershor 2020, ka lëshuar licenca me kategoritë si në grafikun e më poshtëm:



6. Edukimi specialistik-zbërthimi i kompetencës bazuar në Ligjin për Shëndetësi dhe Ligjin për OPSH-të

Dizajnimi dhe fillimi i fazës kalimtare të zbërthimit të kompetencave të edukimit specialistik (zbërthimi ligjor, financiar dhe teknik) është në proces e sipër, duke përfshirë edhe hartimin e UA për shkollim specialistik.

7. Këshilli Mbikëqyrës

Në periudhën kohore prill-qershor 2020, Këshilli Mbikëqyrës i OMK-së ka mbajtur një (1) takim, ku është bërë shqyrtimi i vendimeve të Këshillit Drejtuesligjshmëria e tyre konform akteve juridike të OMK-së dhe ligjeve në fuqi.

8. Komisioni për Çështje Etike i OMK-së

Në periudhën kohore prill–qershor 2020, Komisioni për Çështje Etike i OMK-së ka pranuar dhe ka shqyrtuar dy (2) kërkesë për leje për hulumtim.

Kërkesat e shqyrtuara janë aprovuar nga Komisioni për Çështje Etike dhe aplikuesve u janë lëshuar lejet për hulumtim.

9. Komisioni për Solidaritet dhe Ndhmë Reciproke

Në periudhën kohore prill–qershor 2020, Komisioni për Solidaritet dhe Ndhmë Reciproke ka pranuar një (1) kërkesë për përkrahje financiare. Komisioni ka marrë vendim refuzues lidhur me kërkesën e pranuar.

10. Raporti financiar

10.1 Gjendja financiare – 30 qershor 2020

1.0 Të hyrat:			
1.0.1 Të hyrat e shtyra nga 2019	€304,543.00		
Të hyrat e shtyra nga 2019	€304,543.00		
1.1 Të hyrat	Realizimi: TM1	Realizimi: TM2	TOTAL TM2
1.1.1 Të hyrat nga anëtarësia:			
1.1.2 Anëtarësimi i mjekëve shtetas kosovarë	€232,820.00	€43,180.00	€276,000.00
1.1.3 Anëtarësimi i mjekëve shtetas jo kosovarë	€5,250.00	€2,253.00	€7,503.00
1.1.4 Licencimi	€9,420.00	€5,500.00	€14,920.00
1.1.5 Të hyrat e tjera*	€10,013.00	€2,680.00	€12,692.78
Të hyrat nga TM	€257,503.00	€53,612.78	€311,115.78
Të hyrat e shtyra nga 2019			€304,543.00
TOTAL TË HYRAT			€615,658.78

2.0 SHPENZIMET	Shpenzimet: TM1	Shpenzimet: TM2	TOTAL TM2
2.1 Paga, mëditje dhe kontributet pensionale	€37,267.55	€30,309.68	€67,577.23
2.3 Material shpenzues për zyrë	€1,490.26	€602.64	€2,092.90
2.4 Reprerentacioni	€282.20	€151.11	€433.31
2.5 Edukimi i vazhdueshëm profesional	€4,699.00	(€1,410.00)	€3,289.00
2.6 Shpenzimet e tjera*	€5,036.84	€7,547.40	€12,584.24
2.7 Përkrahje financiare në kuadër të fondit për solidaritet	€6,600.00	€0.00	€6,600.00
TOTAL SHPENZIMET TM:	€55,375.85	€37,200.83	€92,576.68
TOTAL SHPENZIMET			€218,539.10
TOTAL BILANCI			€523,082.10

1.1.5* Taksë administrative për aplikim për ndërrim të kartelës, Regjistrimi në regjistrin e anëtarësisë së OMK-së, Faksimili, Faksimili i dytë, Kongreset, simpoziumet, seminarët, konferenca vendore pa pjesëmarrje ndërkombëtare, aktivitet e organizuara nga kompanitë farmaceutike, Certifikatës për të kaluarën etike, Lejimi për hulumtime bio-mjekësore për anëtarë të Odës, Të hyrat nga dënimet (masat disiplinore), Dhurata / donacione, Të ardhurat të tjera

2.6 *Faksimili, Anëtarësimi në CPME, Shpenzimet e tel., Shpenzimet e int., Shpenzimet e postës, Pajisje të IT, Shpenzime bankare, Shpenzimet e pastrimit, Shpenzimet e transportit, Inventari, Shpenzimet e tjera operative.

10.2 Përkrahje për Edukim të Vazhdueshëm Profesional

Oda e Mjekëve të Kosovës nuk ka pasur asnjë kërkesë për përkrahje financiare për Edukim të Vazhdueshëm Profesional gjatë tremujorit të dytë.

10.3 Prokurimi

Gjatë periudhës kohore prill-qershor 2020, u zhvillua një procedurë e hapur e prokurimit për: Përkthim dhe lektorim të materialeve të OMK-së

Në muajin maj u bë ftesa për tender nga Oda e Mjekëve të Kosovës për të gjitha kompanitë e interesuara që të paraqesin ofertën e tyre për dosje të tenderit për Përkthim dhe lektorim të materialeve të OMK-së. Si rezultati kësaj ftese janë pranuar ofertë nga tre operator ekonomik, mirëpo Komisioni i vlerësimit ka konstatuar se dy aplikues nuk kanë qenë të përgjegjshëm. Andaj Komisioni i vlerësimit të tenderit ka vendosur se për këtë procedurë të prokurimit nuk janë plotësuar kushtet për të vazhduar procedurën e më tutjeme, si rrjedhojë u bë anulimi i procedurës.

11. Aktivitete të tjera

11.1 Shërbimi profesional

Me datën 22 maj 2020, është bërë përzgjedhja për kandidatin e suksesshëm për pozitën Nëpunës i jashtëm për Teknologji Informative sipas konkursit publik të datës 4 mars 2020.

11.2 Tryeza e rumbullakët 'Ligji i pagave dhe Mjekët e papunë'

Me datë 17 Qershor Oda e Mjekëve të Kosovës organizoi tryezën e rumbullakët me temë 'Ligji i pagave dhe Mjekët e papunë'. Qëllimi i organizimit të tryezës ishte që të mbledhë akterët kyç të sektorit shëndetësor për të diskutuar rreth shqetësimit për numrin e madh të mjekëve të papunë, ikja e tyre nga Kosova dhe nevojat e sistemit shëndetësor për mjekë sipas specializimeve.

Pjesëmarrës në këtë tryezë ishin edhe deputetja dhe kryetarja e komisionit për shëndetësi në kuvendin e Kosovës Dr. Albena Reshitaj, përfaqësues të ministrisë së shëndetësisë, ministrisë së financave, kryetarët e odave të profesionistëve shëndetësor, kryetari i federatës së sindikatave të shëndetësisë së Kosovës, dhe përfaqësues të mjekëve specialist të papunë.

Lejimi i pranimit të numrit të ri të mjekëve, 100 mjekë specialist (74 zëvendësime dhe 26 vende të reja të punës) për vitin 2020, hapja e konkursit për 300 pozita për

shkollim specialistik dhe rishqyrtimi i buxhetit, kalkulimi bazuar në ligjin për paga janë disa nga rekomandimet e dala nga kjo tryezë.

11.3 Kongresi vjetor

Ndër aktivitetet kryesore që Oda e Mjekëve ka planifikuar të realizoj për vitin 2020 është Kongresi Mjekësor. Për shkak të respektimit të masave të marra mbrojtëse për parandalimin dhe trajtimin e virusit pandemik COVID 19, organizimi i Kongresit vjetor është shtyrë deri në heqjen e masave mbrojtëse të marra nga Qeveria e Kosovës.

11.4 Revista mjekësore e Odës së Mjekëve të Kosovës

Me propozim të Këshillit Drejtues në mbledhjen e kuvendit të OMK-së u morr vendim për themelimin e Revistës shkencore të Odës së Mjekëve të Kosovës.

Me datë 2 mars Këshilli Drejtues emëroi anëtarët e redaksisë së revistës, ku si rrjedhojë me datë 9 mars u mbajt takimi i parë i anëtarëve. Në takimin e parë u vendos që revista të jetë informative, e cila do të botohet dy herë në vit, për të cilën u propozua që numri i parë të botohet me datë 1 qershor. Për shkak të situatës së shkaktuar nga COVID 19, botimi i revistës është shtyrë deri në stabilizim të situatës bazuar në rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik.

11.5 Marrëdhënie ndërkombëtare

Me datë 3 prill Oda e Mjekëve të Kosovës, ka marr pjesë në takimin virtual të organizuar nga Asambleja e Përgjithshme e Komitetit të Përhershëm të Mjekëve European (CPME), ku temë kryesore ka qenë menaxhimi i situatës të shkaktuar nga COVID-19. Gjatë takimit Dr. Ole Johan Bakke ka udhëhequr temën Shëndetësia Publike dhe parandalimi i sëmundjeve, ku theks të veçantë ju dha rolit të rëndësishëm të mjekëve në adresimin e çështjeve të shëndetit publik. CPME beson se marrëdhënia pacient-mjek është thelbësore në arritjen e cilësisë së lartë të kujdesit shëndetësor për çdo pacient.

Asambleja e Përgjithshme e Komitetit të Përhershëm të Mjekëve European (CPME) ka nxjerrë deklaratë të përbashkët ku i bëjnë thirrje autoriteteve që të garantojnë sigurinë e profesionistëve shëndetësor të cilët janë në vijë të parë në luftimin e COVID 19.

11.6 Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike

Në kuadër të kompetencës publike lidhur me mbikëqyrjen e veprimtarisë profesionale dhe në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional lidhur me veprimtarin profesionale të mjekëve, Kryetari i OMK-së duke u bazuar në kompetencat ligjore sipas Ligjit për OPSH-të, në bazë të kërkesave nga Gjykatat dhe prokurorit publike të Kosovës, ka caktuar ekspert apo grupe të ekspertëve lidhur me konstatimin e përgjegjësisë profesionale mbi zbatimin e procedurave mjekësore nga mjekët gjegjës. Ekspertiza të tilla kanë qenë në shërbim të konstatimit të përgjegjësisë individuale të mjekëve të cilët u janë nënshtruar procedurave penale apo dhe civile, qoftë në fazën hetimore apo gjatë shqyrtimeve gjyqësore.

Ekspertizat:

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën TM2	Vendimet sipas urdhëresave së pranuar për periudhën TM2	Në procedurë	Raportet e ekspertizave të përfunduara për periudhën TM2	Lëndët e bartura nga periudhat paraprake
Kryetari i Odës	2	0	3	1	2

11.7 Shpallja e Emergjencës së shëndetit publik

Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur me 15 mars 2020, shpalli emergjencën për shëndetin publik, si dhe morri vendimin nr. 01/09. ku sipas këtij vendimi janë përcaktuar masat mbrojtëse për parandalimin dhe trajtimin e virusit pandemik COVID 19. Me qëllim të zbatimit të vendimit dhe për shkak të natyrës së veçantë të veprimtarisë së OMK-së, nga data 16 mars 2020, OMK-ja ka pezulluar punën me palë pranë selisë së saj, kështu që zyrat e selisë së OMK-së kanë qenë të mbyllura deri me datë 12 maj 2020. Të gjitha shërbimet e mundshme për anëtarët e OMK-së janë rekomanduar që gjatë kësaj kohe të bëhen përmes ueb faqes zyrtare të OMK-së dhe postës zyrtare elektronike të OMK-së.

12. Plani i veprimit për 2020

Projektet afatmesme dhe afatgjata

- Projekti për ndërtimin e një objekti për të gjitha OPSH-të, mbështetur nga MSH-ja, financuar nga Projekti KSV/017 “Përkrahja për Sektorin e Shëndetësisë”. Kësaj iniciative i janë përgjigjur të gjitha OPSH-të dhe kërkesa zyrtare për mbështetje është nënshkruar nga të gjitha OPSH-të, dhe më pas është dorëzuar në MSH. Fillimi i ndërtimit pritet të fillon pas miratimit të marrëveshjes për vazhdimin e projektit të KSV/017 nga Kuvendi i Kosovës.
- Pas miratimit të kërkesës nga OMK-ja drejtuar LuxDev-it lidhur me përkrahje financiare për zhvillimin e sistemit informativ/bazës interaktive të të dhënave, ku do të përfshihen të gjitha proceset e OMK-së.
- Zbërthimi dhe bartja e kompetencave për edukimin specialistik bazuar në Ligjin për Shëndetësi dhe Ligjin për OPSH-të.
- Botimi i Revistës mjekësore.
- Organizimi i Kongresit vjetor i fokusuar në lëmin e Onkologjisë.